



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

V E N D I M

Nr. 111, Datë 23/08/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 62, datë 29.05.2019, e Z. T.M., ku pretendohet diskriminim, për shkak të “gjendjes shëndetësore”, nga ana e Z. J.M., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe njëkohësisht N/Kryetar i Bashkisë Sarandë dhe Z. V.V., Shef i Policisë Bashkiake Sarandë.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se Z. T.M., i ditëlindjes 22.09.1955, lindur e banues në qytetin e Sarandës, në rrugën “Lefter Talo”, P. 153, është invalid i plotë¹. Për këtë arsye, për të lehtësuar aksesin në banesën e tij, në bazë të Autorizimit nr. 2044/1, datë 31.07.2018, të Bashkisë Sarandë, ankuesi T.M. dhe Z. F. Z.² janë autorizuar të kryejnë punime për vendosjen e një rampe me konstrukcion të lehtësuar metalik, për përshtatjen e ndërtesës së banimit, për personat me aftësi të kufizuara.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se Bashkia Sarandë vuri në dispozicion të ankuesit dhe Z. F. Z., skicën e e vendndërtimit të rampës, e cila fillonte nga trotuari i rrugës e ngjitej deri tek skaji përëndimor i verandës së pallatit, sipërfaqe, e cila mbështetur në shkresën nr. 4533 prot., datë 20.07.2018, të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajjtëshme Sarandë ndodhet në

¹ Referuar Dëshmisë nr. 6, lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë dhe vendimit të KMCAPI Sarandë, si dhe sipas Vërtetimit të lëshuar nga DRSSH Sarandë, në datën 13.12.2018, rezulton se me Vendimin nr. 1298, datë 13.12.2018, të KMCAPI Sarandë, Z. T.M. plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet të plotë prej datës 01.01.2019-31.12.2019.

² Fqinj i tij, i cili sipas pretendimeve të ankuesit, është person me aftësi të kufizuara;

bashkëpronësi me shtetasit V. H. dhe banorëve të pallatit. Ankuesi pretendon se Z. V.H. ka në pronësi të tij një sipërfaqe prej 40 m², të cilën e shfrytëzon si lokal³. Por përveç kësaj sipërfaqeje, ai shfrytëzon edhe 15 m² sipërfaqe të verandës së pallatit, të cilën e ka në pronësi të përbashkët me banorët e pallatit, ku banon ankuesi.

Z. T.M. thekson faktin se veranda e pallatit shfrytëzohet si lokal, duke e bërë të pamundur aksesin e tij, si invalid në këto ambiente, për të shkuar në banesën e tij. Për këtë arsye, ai i është drejtuar disa herë me kërkesë me shkrim, Bashkisë Sarandë, Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe Policisë Bashkiake të këtij institucioni, por nga ana e këtij institucioni nuk ka patur asnjë reagim zyrtar për të ndërhyrë dhe për të zgjidhur çështjen konkrete. Ankuesi pretendon se përveç sa më sipër, biznesi i shtetasit V. H. është i palicensuar dhe i paligjshëm. Pavarësisht ankesave dhe kërkesave të shumta me shkrim, që ankuesi ka paraqitur pranë Bashkisë Sarandë, ky institucion nuk i ka kthyer asnjëherë përgjigje zyrtare dhe nuk ka kryer asnjë ndërhyrje në zbatim të kompetencave të tij ligjore. Z. T.M. pretendon diskriminim për shkak të gjendjes së tij shëndetësore nga ana e Z. J.M., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe njëkohësisht N/Kryetar i Bashkisë Sarandë dhe Z. V.V., Shef i Policisë Bashkiake Sarandë, pasi ata nuk kanë vepruar në zbatim të kompetencave të tyre ligjore, për të mbrojtur të drejtat e tij si qytetar dhe si person që ndodhet në gjendje jo të mirë shëndetësore, duke e lënë të ekspozuar përballë fyerjeve, kërcënimeve e pengimit për akses në banesën e tij, nga pronari i biznesit V. H.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 62, datë 29.05.2019, e Z. T.M., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Znj. Floriana Koka, Kryetare e Bashkisë Sarandë, Z. J.M., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Z. V.V., Shef i Policisë Bashkiake Sarandë, me shkresën nr. 934, datë 10.06.2019, ku kërkohet informacion, si më poshtë vijon:

³ Lokali “Jurgen”, Sarandë.

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

1. Informacion i hollësishëm mbi çështjen e parashtruar nga ankuesi;
2. Informacion, nëse është ngritur rampa, sipas autorizimit dhe skicës përkatëse, të lëshuar nga Bashkia Sarandë, në pallatin, ku banon ankuesi T.M.. Të përcillen pranë Komisionerit, kopje të autorizimit dhe skicës së rampës;
3. Informacion mbi ankesat e depozituara nga ankuesi T.M. pranë Bashkisë Sarandë. Të përcillen pranë Komisionerit, kopje të këtyre ankesave;
4. Kopje të të gjithë shkresave zyrtare dërguara nga Bashkia Sarandë, në adresë të ankuesit T.M.;
5. Kopje të të gjitha shkresave zyrtare të dërguara nga Bashkia Sarandë, në adresë të pronarit të biznesit Kafe “Jurgen” Sarandë;
6. Informacion mbi mënyrën, se si është reaguar nga Bashkia Sarandë, si mbi masat e marra nga ky institucion, për zgjidhjen e problemit të Z. T.M..

Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijeni edhe ankuesit.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 934, datë 10.06.2019, së Komisionerit, Bashkia Sarandë dërgoi shkresën nr. 1026, datë 26.06.2019, nëpërmjet së cilës e informon KMD-në, se në datën 22.07.2018, Z. T.M. i është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Sarandë, ku kërkon leje për vendosjen e një rampe për të realizuar hyrjen dhe daljen në pallat të personave me aftësi të kufizuar. Në datën 31.07.2018, Z. T.M. dhe Z. F. Z. (persona me aftësi të kufizuar, banorë të këtij pallati) pajisen me autorizim për ndërtimin e rampës, duke u mbështetur në verandën e pallatit (pronë e përbashkët e banorëve të pallatit). Në pamundësi të ndërtimit të rampës në krahë të shkallëve hyrëse për shkak të lartësisë së madhe, ajo u planifikua dhe u ndërtua në pjesën perëndimore të verandës. Kjo mundësoi kalimin e personave me aftësi të kufizuar në të gjithë verandën. Njëkohësisht, Z. T.M. i është mundësuar nga ana e Bashkisë Sarandë, një vend parkimi përballë rampës, në kushtet kur, ai është një person me aftësi të kufizuara. Rruga automobilistike ndërmjet rampës dhe vendparkimit të tij është vijëzuar me vija të bardha për t’i lehtësuar kalimin e rrugës automobilistike.

Megjithë plotësimin e kërkesave nga ana e Bashkisë, Z. T.M. i është drejtuar dhe Avokatit të Popullit. Mbështetur në shpjegimet që kërkonte Avokati i Popullit, patrulla e Policisë Bashkiake, në datën 15.10.2018 kreu verifikimin e ankesës në vend dhe u konstatua se rampa ishte funksionale dhe se Z. T.M. nuk kishte pretendime.⁵

Në vijim, në datën 23.01.2019, Avokati i Popullit iu drejtua me shkresë zyrtare Bashkisë Sarandë, ku kërkohet informacion në bazë të një ankese të depozituar nga Z. T.M., i cili pretendonte që rampa e vendosur nga Bashkia ishte hequr nga Z. Vladimir Hysi. Përsëri, patrulla e Policisë Bashkiake kreu verifikimin e ankesës në vend, ku konstatoi se rampa ishte në rregull. Patrulla e Policisë Bashkiake mori kontakt me ankuesin, nga ana e të cilit u konfirmua sërish se rampa ishte në rregull dhe se nuk kishte asnjë shqetësim⁶. Gjithshka e përmendur sa më sipër

⁵ Referuar Raportit të shërbimit të patrullës së Policisë Bashkiake, të datës 15.10.2018.

⁶ Referuar Akt-kontrollit Nr. 19, datë 26.01.2019, të patrullës së Policisë Bashkiake, të datës 15.10.2018

rezulton e reflektuar në Akt-kontrollin Nr. 19, datë 26.01.2019, të patrullës së Policisë Bashkiake, që rezulton e nënshkruar edhe nga ankuesi T.M..

Për sa më sipër, në referencë të ankesës së Z. T.M., Bashkia Sarandë i është drejtuar Avokatit të Popullit, me shkresën nr. 280/3, datë 05.02.2019, nëpërmjet së cilës i konfirmon funksionimin normal të rampës.

Në datën 28.03.2019 dhe datën 15.04.2019, Z. T.M. paraqitet pranë Bashkisë Sarandë dhe ankohet se Z. Vladimir Hysi, duke mbajtur tavolina në verandë e pengon për të hyrë e për të dalë nga shtëpia e tij. Në vijim, Bashkia Sarandë i kthen përgjigje zyrtare Z. T.M., ku i rekomandon se zgjidhja e konflikteve civile është kompetencë e gjykatës dhe jo e Bashkisë Sarandë, pasi veranda e pallatit është pronë e përbashkët e banorëve të pallatit dhe jo hapësirë publike.

Nëpërmjet shkresës nr. 1142/1, datë 16.05.2019, Bashkia Sarandë i dërgon të njëjtën shkresë edhe Avokatit të Popullit, pas ankesës që Z. T.M. depozitoi pranë këtij institucioni dhe kërkesës për informacion, që Avokati i Popullit dërgoi në adresë të Bashkisë Sarandë.

Ndër të tjera, Bashkia Sarandë e bën me dije Komisionerin se në vijim, përkatësisht, në datën 20.04.2019, Z. Vladimir Hysi është ankuar pranë këtij institucioni, ndaj Z. T.M., pasi pretendon se ky i fundit shfrytëzon hapësirën e përbashkët (verandën), duke mos qenë banor i këtij seksioni të pallatit⁷. Në ankesën e tij, Z. Hysi kërkon edhe shfuqizimin e autorizimit nr. 2044/1, datë 31.07.2018, të Bashkisë Sarandë, për vendosjen e rampës pasi shkel të drejtat e banorëve të shkallës nr. 1. Bashkëlidhur ankesës së Z. Hysi është dërguar edhe deklarata e 18 banorëve të shkallës nr. 1. Z. Hysi i është drejtuar edhe Avokatit të Popullit, i cili me shkresën e datës 24.04.2019, kërkon informacion nga Bashkia Sarandë. Nëpërmjet shkresës nr.1141/1, datë 16.05.2019, Bashkia Sarandë i kthen përgjigje Avokatit të Popullit, duke sqaruar se në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, kompetencën për zgjidhjen e konflikteve civile e ka gjykata dhe jo Bashkia Sarandë.

Në vijim, Bashkia Sarandë informon se pretendimi i ankuesit se biznesi i shtetasit Vladimir Hysi është i palicëncuar dhe i paligjshëm nuk qendron, pasi aktiviteti i këtij shtetasi është i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L84104805A, sot me emrin Meriban Hysi.⁸ Taksimi i tij kryhet mbështetur në parashikimin e nenit 22, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar) dhe nenit 2, pika 1.1, të Vendimit nr. 132, datë 07.03.2018, të Këshillit të Ministrave, *“Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.* Dokumenti bazë, mbi të cilën Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore procedon është dokumenti ligjor që vërteton pronën e tij. Ky dokumentacion ndodhet në dosjen përkatëse të subjektit.

⁷ Pallati ka dy seksione dhe ankuesi banon në seksionin nr. 2, të tij.

⁸ Referuar ekstraktit historik, të datës 18.06.2019.

Për sa më sipër, Bashkia Sarandë thekson faktin se ankuesi nuk është diskriminuar për asnjë nga shkaqet e pretenduara, pasi edhe vetë Z. T.M. ka ndjekur këtë procedurë për ta taksuar subjektin, në vitet 2014 dhe 2015, kur kryente detyrën e Drejtorit të Taksave në Bashkinë e Sarandës. Në cilësinë e provës, Bashkia Sarandë ka depozituar pranë KMD-së, Njoftim Vlerësim Tatimor nr. 37/15, datë 12/12/2014 dhe Njoftim Vlerësim Tatimor Nr. 37/14 prot., datë 23.03.2015, ku rezulton se subjekti është taksuar për 40 m² sipërfaqe. Këto akte janë të nënshkruara nga Z. T.M., dikur në pozicionin e Drejtorit të Taksave në Bashkinë e Sarandës dhe aktualisht në cilësinë e ankuesit pranë KMD-së.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 62, datë 29.05.2019, së Z. T.M., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Pretendimet e Z. T.M., për diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*”, drejtohen kundër Z. J.M., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe njëkohësisht N/Kryetar i Bashkisë Sarandë dhe Z. V.V., Shef i Policisë Bashkiake Sarandë.

Pretendimet ndaj Z. J.M., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore konsistojnë në faktin se, ai nuk ka vepruar sipas dispozitave ligjore në fuqi ndaj biznesit të shtetasit V. H., i cili sipas ankuesit është biznes i paligjshëm, ndërkohë që pretendimi i ankuesit ndaj Z. V.V., Shef i Policisë Bashkiake Sarandë konsiston në faktin që kjo strukturë e Bashkisë Sarandë nuk ka vepruar në zbatim të kompetencave të tyre ligjore, për të mbrojtur të drejtat e tij si qytetar dhe si person që ndodhet në gjendje jo të mirë shëndetësore, duke e lënë të ekspozuar përballë fyerjeve, kërcënimeve e pengimit për akses në banesën e tij, nga pronari i biznesit Vladimir Hysi.

Për sa më sipër, ankuesi ka pretenduar diskriminim të tij, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, nga subjektet e mësipërme. Në kushtet kur, strukturat e mësipërme dhe drejtuesit e tyre janë pjesë e Bashkisë Sarandë, si dhe në kushtet, kur shkresa përgjigje në adresë në KMD-së, ka ardhur nga ky institucion dhe është e nënshkruar nga titullarja e tij, subjekt i ankesës së Z. T.M. do të konsiderohet Bashkia Sarandë.

Në këtë seksion, mbi bazën e provave të administruara, Komisioneri do të japë vlerësimin dhe gjykimin e tij, nëse Z. T.M. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, nga ana e Bashkisë Sarandë.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit se Bashkia Sarandë nuk ka vepruar në zbatim të kompetencave të saj ligjore, për të mbrojtur të drejtat e tij si qytetar dhe si person që ndodhet në gjendje jo të mirë shëndetësore, kundrejt shtetasit Vladimir Hysi, Komisioneri ka konstatuar se kjo problematikë ndahet në dy momente kryesore:

Momenti i parë, konsiston në ankesën nr. 2044, datë 24.07.2018, e Z. T.M., drejtuar Bashkisë Sarandë, në lidhje me prishjen e rampës ekzistuese (paraardhëse) nga ana e Z. Vladimir Hysi. Në vijim të kësaj ankesë, Bashkia Sarandë miratoi Autorizimin nr. 2044/1, datë 31.07.2018, nëpërmjet së cilit u mundësua ngritja e një rampe të re me konstrukcion të lehtësuar metalik. Në vijim, mbi bazën e provave të administruara, përkatësisht Raportit të Shërbimit të datës 15.10.2018, ora 18:30, dhe Akt-kontrollit Nr. 19, datë 26.01.2019, ora 15:30, Komisioneri ka konstatuar se patrullat e Policisë Bashkiake janë paraqitur pranë vendbanimit të Z. T.M., për kryerjen e verifikimeve përkatëse në bazë të sinjalizimit të ardhur nëpërmjet ankuesit⁹ dhe Avokatit të Popullit. Në aktet e mësipërme rezulton se ankuesi nuk ka pretendime dhe situata është e qetë, pra rampa është funksionale dhe përdoret normalisht nga personat me aftësi të kufizuar banorë të këtij pallati. Në këtë kontekst, Komisioneri çmon se Policia Bashkiake Sarandë ka vepruar dhe reaguar ndaj ankesës së Z. T.M. dhe sidomos pas shkresave të dërguara nga Avokati i Popullit, të cilin në vijim e ka njoftuar mbi rezultatet e verifikimeve.

Momenti i dytë, konsiston në ankesat vijuese të Z. T.M., përkatësisht në datat 28.03.2019 dhe 15.04.2019, nëpërmjet së cilave ai ankohet pranë Bashkisë Sarandë, ndaj Z. Vladimir Hysi, duke e akuzuar se ky shtetas ka okupuar hapësirën e përbashkët të verandës së pallatit, të cilën e zotëron në bashkëpronësi me banorët e pallatit dhe aty ushtron biznesin e tij privat, i cili është një lokal, tavolinat dhe karriget e së cilit, zënë sipërfaqen e verandës, duke e bërë të pamundur kalimin e ankuesit për në banesën e tij. Veranda e pallatit është kalim i detyrueshëm për Z. T.M., për të patur akses në apartamentin, ku ai banon. Me shkresën nr. 1033, datë 18.04.2019, Bashkia Sarandë i ka kthyer përgjigje ankuesit duke e bërë me dije se : *“Bashkia Sarandë pasi shqyrtoi problematikën që ju parashtroi, si dhe referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 1, të ligjit nr. 10 112, datë 09.04.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në banesat e ndërtimit”, neni 6, si dhe Vendimit nr. 447, datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, neni 33/1/a, 3/2/a, 34/1 etj. konkludoi se nuk mund të marrë asnjë masë për asye se problemi juaj ja të bëjë me një konflikt civil, jo administrativ.”* Bashkia Sarandë ka dërguar të njëjtën përgjigje edhe Avokatit të Popullit, nëpërmjet shkresës nr. 1142/1, datë 16.05.2019.

Në kushtet kur, biznesi/lokali i Z. Vladimir Hysi shtrihet në verandën e pallatit, sipërfaqja e së cilës ndodhet në bashkëpronësi të banorëve të pallatit dhe të Z. Hysi, ankuesi pretendon se ky biznes pengon lëvizjen e tij për të kaluar në apartamentin e tij. Në këto kushte, Z. T.M. kërkon ndërhyrjen dhe veprimin më aktiv të policisë bashkiake për të rregulluar një situatë të tillë, duke mos rënë dakord me me përgjigjen zyrtare të Bashkisë Sarandë.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, Bashkia ka kompetenca që konsistojnë në përmbushjen e funksioneve publike në interes të komunitetit që përfaqëson, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sipas këtij ligji, bashkitë veprojnë dhe i ushtrojnë funksionet e tyre në interes publik dhe këto kompetenca shtrihen vetëm në ato hapësira, të cilat ndodhen nën juridiskionin përkatës dhe janë nën administrimin e saj, publik.

⁹ Referuar kërkesës nr. 2044, datë 24.07.2018, të Z. T.M. drejtuar Bashkisë Sarandë.

Gjithashtu, në pikën 1, të nenit 8 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikohet: “1. Organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohet me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror.”

Në kontekstin e parashikimeve të mësipërme, rezulton se Bashkia vepron vetëm në ato hapësira që janë publike dhe brenda kompetencave që këtij institucioni i atribuohen nga dispozitat ligjore përkatëse.

Për të patur një vision sa më të qartë të çështjes në shqyrtim, si dhe për të evidentuar rolin dhe kompetencat që ka Bashkia Sarandë në rastin konkret, Komisioneri mori në analizim dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar)¹⁰, ligjit nr.10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” dhe Vendimit nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”.

Në Kreun II/A, përkatësisht në nenet 209 – 221, të Kodit Civil përcaktohet “Bashkëpronësia e Detyrueshme” dhe më specifikisht mbi objektet e përbashkëta të ndërtesave. Në nenin 209, të Kodit Civil parashikohet shprehimisht:

“Në katet ose njësitë e ndara të kateve të një ndërtese që ndodhen në pronësi të veçantë të pronarëve të ndryshëm, janë në bashkëpronësi të detyrueshme të tyre, gjersa në aktin e pronësisë nuk është caktuar ndryshe, këto objekte:

- a) trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa, themelet, muret kryesore, muret ndarëse të brendshme, shkallët, hollet, çatia ose taraca, oxhaqet, si edhe të gjitha ato objekte të ndërtesës, që kanë karakter të tillë dhe shërbejnë për përdorim të përbashkët;*
- b) pusët, instalimet e ujit, instalimet elektrike, të gazit, të telefonisë e të ngrohjes qendrore, duke përfshirë edhe tubacionet dhe linjat përkatëse, si dhe kanalet e ndryshme deri në pikën e degëzimit të tyre brenda njësisve të ndara të kateve.*

Në referencë të neneve 210-211 të Kodit Civil, e drejta e secilit bashkëpronar mbi sendet e përmendura në nenin e mësipërm, është në përpjesëtim me vleftën e katit ose të pjesëve të katit që i përkasin atij, përveç kur titulli parashikon ndryshe. Heqia dorë nga e drejta mbi sendet e mësipërme, nuk e liron bashkëpronarin nga detyrimi për të kontribuar në shpenzimet përmbajtjen e tyre. Objektet e përbashkëta të ndërtesës nuk lejohet të ndahen, përveç kur ndarja e ndonjërit prej tyre mund të kryhet pa ia vështirësuar përdorimin e tij asnjërit nga bashkëpronarët.

Në nenin 212 e Kodit Civil parashikohet krijimi i Asamblesë së bashkëpronarëve të ndërtesës dhe kryesisë së saj, duke përcaktuar edhe kompetencat e saj. Kryesia ngarkohet të kryejë, në emër e për llogari të tyre të gjitha veprimet e nevojshme për administrimin dhe mirëmbajtjen e

¹⁰ Në vijim do t’i referohemi Kodi Civil.

zakonshme të objekteve të përbashkëta, përveç atyre veprimeve që janë në kompetencë vetëm të asamblesë, si dhe të përfaqësojë në instancat gjyqësore kompetente dhe në arbitrazh. Neni 212 e vijues përcaktojnë përbërjen e Asamblesë, zgjedhjen e kryesisë dhe kompetencat e Asamblesë¹¹, e cila ka funksione të mirëpërcaktuara në drejtim të administrimit të ndërtesës dhe ambienteve të përbashkëta.

Në rastin konkret, rezulton se Asambleja e pallatit ku banon ankuesi, nuk funksionon, pasi nga faktet e administruara rezulton se nuk ka ndërhyrje dhe vendimmarrje nga një organ i tillë për zgjidhjen e çështjes konkrete.

Në nenin 217, të Kodit Civil, përcaktohen edhe detyrimet e bashkëpronarëve, që konsistojnë si vijojnë: *1. Të paguajë shpenzimet për ruajtjen dhe gëzimin e pjesëve të përbashkëta të ndërtesës, për kryerje shërbimesh në dobi të përbashkët dhe për ndryshime të vendosura nga shumica e bashkëpronarëve, në përpjesëtim me vleftën e pjesës së secilit, përveç kur ka marrëveshje tjetër. Për sendet që u shërbejnë bashkëpronarëve në masë të ndryshme, shpenzimet përballohen në përpjesëtim me përdorimin që mund t'u bëjë atyre secili. 3. Të paguajë shpenzimet për ruajtjen dhe gëzimin e pjesëve të përbashkëtatë ndërtesës, për kryerje shërbimesh në dobi të përbashkët dhe për ndryshime të vendosura nga shumica e bashkëpronarëve në përpjesëtim me vleftën epjesës të secilit, përveç kur ka marrëveshje tjetër.2. Të mos kryejë në katin ose njësinë e ndarjes së katit, që është në pronësi të veçantë të tij, ndërtime të cilat mund t'u shkaktojnë dëme objekteve të përbashkëta të ndërtesës.3. Të ndreqë dëmin ose të paguajë shpenzimet për zëvendësimine tij, që ai vetë ose një anëtar i familjes së tij i ka shkaktuar me faj,cilitdo objekti të përbashkët.4. Të mos kryejë, pa lejen paraprake të asamblesë, në katin ose në njësinë e ndarë të katit që është në pronë të tij, shtesa ose ndryshime të cilat mund të çënojnë pamjen e jashtme të ndërtesës.”*

Për sa më sipër, konstatohet që Kodi Civil përmban parashikime dhe rregulla të përgjithshme mbi bashkëpronësinë e detyrueshme, pa i atribuar kompetenca apo tagra specifike organeve të pushtetit vendor, ndërkohë që ligji nr.10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” dhe Vendimi nr. 447, datë 16.06.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” kanë kryer përcaktime më të detajuara, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen në shqyrtim.

¹¹ Asambleja ka edhe këto kompetenca kryesore: Miraton rregulloren për administrimin e banesës, e cila hartohet sipas rregullores tip të miratuar nga Këshilli i Ministrave;Krijon fondin rezervë për shpenzimet e përbashkëta, duke caktuar edhe shumën vjetore të tij;Miraton preventivat e shpenzimeve që ka vendosur të kryhen gjatë vitit, si dhe ndarjen e shumës së tyre midis bashkëpronarëve. Shpenzimet e përbashkëta për mirëmbajtjen, riparimet dhe përmirësimet e zakonshme të këtyre objekteve miratohen nga asambleja me shumicë të thjeshtë votash, ndërsa shpenzimet për përmirësime të mëdha ose rinësime cilësore vendosen me shumicë të cilësuar të bashkëpronarëve që arrijnë të paktën 75% të kuotave përkatëse; Emëron, kur çmohet e domosdoshme, kujdestarin e ndërtesës, duke caktuar kompetencat dhe pagën e tij;Autorizon kryesinë që të sigurojë, brenda kufijve të arsyeshme,objektet që janë pronë e përbashkët, si dhe të lidhë kontrata të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen, riparimet dhe përmirësimet e zakonshme, ose, sipas rastit, për përmirësime të mëdha apo rinësime të këtyre objekteve.

Në nenin 6 “*Bashkëpronësia e njësive*”, të ligjit nr.10 112, datë 9.4.2009 “*Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit*” parashikohet: “*Në njësitë ku ka dy ose më shumë pronarë, marrëdhëniet e bashkëpronësisë ndërmjet pronarëve rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit Civil, të këtij ligji dhe të rregullores së administrimit të banesave.*” Sikurse vihet re nga parashikimi i dispozitës së mësipërme, bashkëpronësia në ndërtesat e banimit rregullohet nga dispozitat e Kodit Civil, dispozitat rregulluese të ligjit nr.10 112, datë 9.4.2009 “*Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit*”, si dhe të Vendimit nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit*”.

Gërma a), e nenit 9 “*Të drejtat e pronarit të njësisë*” të ligjit nr.10 112, datë 9.4.2009 “*Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit*” parashikon të drejtën e pronarit të njësisë të kërkojë nga bashkëpronarët e tjerë, në bashkëpronësinë e detyrueshme ku bën pjesë, apo dhe nga përdoruesit e këtyre njësive të veçanta, të mos e cënojnë përdorimin dhe gëzimin e objekteve të pandashme, si dhe të kërkojë dëmshpërblim apo ndreqje të dëmit, kur dëmi është shkaktuar nga veprimet e tyre.

Gërmat a) dhe b) të nenit 10, të ligjit të sipërpërmendur parashikojnë detyrimet e pronarit të njësisë, ku sipas parashikimit të këtij neni, pronari i njësisë ka detyrimet e mëposhtme: a) të respektojë normat e etikës dhe të bashkëjetesës, të përcaktuara në rregulloren e administrimit të ndërtesave; b) të mos i pengojë bashkëpronarët e tjerë në gëzimin e objekteve, që janë në bashkëpronësi të detyrueshme. Në njësitë ku ka dy ose më shumë pronarë, marrëdhëniet e bashkëpronësisë ndërmjet pronarëve rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit Civil, të këtij ligji dhe të rregullores së administrimit të banesave.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se dispozita e mësipërme i siguron Z. T.M., sikurse edhe çdo individ tjetër në cilësinë e bashkëpronarit në ambientet e përbashkëta të pallatit ku banon, që të gëzojë në mënyrë të plotë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga pronësia mbi sendin, sikurse nuk lejon cënimin e kësaj të drejte nga bashkëpronarët e tjerë.

Ndërkohë që, zgjidhja e konflikteve ndërmjet bashkëpronarëve, në banesat ku ekziston bashkëpronësia, parashikohen shprehimisht në nenet 35-36 të Vendimit nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit*”, ku parashikohet shprehimisht, si vijon:

“1.Bashkëpronarët mundohen t'i zgjidhin konfliktet me mirëkuptim dhe kur nuk arrihet mirëkuptimi, sipas përkatësisë kryesia, administratori ose njëri prej bashkëpronarëve mund t'i drejtohet njërit prej organeve më poshtë:

a) *Policisë bashkisë/komunës për mosrespektim të normave detyruese sipas nenit 34, kreu VII;*

b) *Inspektoratit vendor ndërtimor urbanistik për ndërhyrje të pamiratuara në pjesët a objektet e pronës së përbashkët;*

c) Inspektorati shëndetësor për mosrespektim të kushteve higjiëno-shëndetësore;

d) Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpërthimet (PMNZSH) në nivel vendor për mos respektim të kushteve për mbrojtjen nga zjarri.

2. Kryesia si dhe çdo bashkëpronar, mund t'i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e konflikteve që nuk kanë gjetur zgjidhje me mirëkuptim, ose kur masa e marrë nga njëri prej institucioneve si më sipër, konsiderohet jo e drejtë.”

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton se ligjvënësi ka parashikuar kompetenca të strukturave të organeve vendore, për të ndërhyrë në rastet e zgjidhjes së konflikteve ndërmjet bashkëpronarëve, në banesat ku ekziston bashkëpronësia e detyrueshme. Referuar gjermës f), të pikës 3, të nenit 34, të Kreu VII të VKM-së së sipërpërmendur parashikohet: “Zonat e përbashkëta brenda ose jashtë godinës së banimit, si shkallët, sheshpushimet, tarracat, verandat e përbashkëta, lulishtet dhe vendkalimet nuk do të përdoren për ruajtje, parkime ose të bllokohen”. Njëkohësisht mbështetur në gjermën d), të pikës 4, të nenit 34, të kreu VII të VKM-së së sipërpërmendur parashikohet: “Asnjë shërbim, aktivitet tregtie ose aktivitet e veprimtari e dëmshme ose fyese nuk do të kryhet brenda zonave të përbashkëta, dhe nuk do të kryhet asnjë veprim që mund të përbejë shqetësim, bezdisje për fqinjësinë ose bashkëpronarët e tjerë.”

Komisioneri gjykon se parashikimet e mësipërme mund të përdoren drejtpërdrejt për rastin e Z. T.M.. Z. Vladimir Hysi ka ushtruar një aktivitet biznesi në një verandë pallati që ndodhet në bashkëpronësi, të tij me banorët e tjerë të pallatit. Ushtrimi i një aktiviteti të tillë ndalohet të kryhet në ambientet e përbashkëta, ka sjellë shqetësim në tek njëri prej bashkëpronarët e kësaj verande dhe aq më tepër ka sjellë si pasojë mos garantimin e aksesueshmërisë për në banesën e tij.

Pika 2 e nenit 35, të Vendimit nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, parashikon: *“Kryesia si dhe çdo bashkëpronar, mund t'i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e konflikteve që nuk kanë gjetur zgjidhje me mirëkuptim, ose kur masa e marrë nga njëri prej institucioneve si më sipër, konsiderohet jo e drejtë.”*

Në rastin konkret, Komisioneri çmon se Bashkia Sarandë nuk ka marrë asnjë masë për të ndaluar pengesën e Z. T.M., për të patur aksesueshmëri të plotë për në banesën e tij. Komisioneri gjykon se në referencë të dispozitës së mësipërme, Bashkia Sarandë duhet të kishte marrë masat përkatëse për zgjidhjen e çështjes në fjalë, aq më tepër që ankuesi është ankuar me shkrim më shumë se një here, pranë këtij institucioni. Fakti që ankuesi mund t'i drejtohej në cdo kohë pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e çështjes, nuk justifikon mosveprimin e Bashkisë Sarandë.

Në mbështetje të argumenteve të mësipërme, Komisioneri vë në dukje faktin se në bazë të pikës 3, të nenit 29 “Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku parashikohet shprehimisht: *“Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve:3. Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në*

komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet” përcaktohet qartësisht detyrimi i Bashkisë Sarandë për të ndërhyrë e për të zgjidhur me ndërmjetësim konfliktin ndërmjet Z. T.M. dhe Z. Vladimir Hysi, i cili u është kundër përgjigjur ankesave të Z. T.M., me ankesa të anasjellta në drejtim të tij. Masat që mund të merreshin nga Bashkia Sarandë, do të kishin çuar në një zgjidhje të konfliktit, pa qenë e nevojshme, që çështja të zgjidhej gjyqësisht.

Në këto kushte, në interpretim të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Z. T.M. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga Bashkia Sarandë.

B. Shkaku i mbrojtur

Në ankesën nr. 62, datë 29.05.2019, e Z. T.M., pretendohet diskriminim, për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e Bashkisë Sarandë.

1. “Gjendja shëndetësore” është një prej shkaqeve, për të cilat, ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”, Komisioneri gjykon se pavarësisht se ky konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, si dhe janë depozituar fakte dhe prova të mjaftueshme nga ankuesi që provojnë gjendjen e tij shëndetësore.

1. Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, Komisioneri gjykon se në cilësinë e shkakut të diskriminimit, duhet marrë në konsideratë aftësia e kufizuar e ankuesit, pasi referuar provave të depozituara nga ankuesi, dhe specifikisht referuar Dëshmisë nr. 6, lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë dhe Vërtetimit të lëshuar nga DRSSH Sarandë në datën 13.12.2018¹², rezulton se Z. T.M. është invalid i plotë, pra është individ me aftësi të kufizuara.

“Aftësia e kufizuar” është një prej shkaqeve, për të cilat, ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë,

¹² Sipas Vërtetimit të lëshuar nga DRSSH Sarandë, në datën 13.12.2018, rezulton se me vendim Nr. 1298, datë 13.12.2018, të KMCAP Sarandë, Z. T.M. plotëson për të fituar të ardhura për invaliditet të plotë prej datës 01.01.2019-31.12.2019.

gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se në rastin konkret aftësia e kufizuar rezulton si shkak diskriminimi i mbrojtur ligjrisht, por edhe është e mbështetur në fakte dhe në prova konkrete.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

1. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “aftësinë e kufizuar”.

Komisioneri çmon faktin se mbi bazën e provave të paraqitura, rezulton se Z. T.M. është një individ me gjendje shëndetësore jo të mirë, e cila ka sjellë si pasojë edhe aftësinë e tij të kufizuar.

Në kushtet kur ai është një person me aftësi të kufizuara¹³, si i tillë gëzon një sërë të drejtash në bazë të legjisllacionit në fuqi.

Për sa më sipër, Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹⁴ në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre, të barabartë në shoqëri.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

¹³ Referuar Dëshmisë nr. 6, lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë;

¹⁴Ratifikuar me ligjin nr 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe akses në strehim¹⁵. Në gërmën “a”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” parashikohet se: “Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: a) në strehim të përshtatshëm dhe të jetojnë ku dhe me kë të dëshirojnë....”. Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, *jetesa e pavarur*, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave.

Në nenin 40, pika 1, gërma b) të ligjit nr. 10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” parashikohet shprehimisht: “Bashkia/komuna mund të hartojë një program nxitjeje për restaurimin apo rikonstruksionin e ndërtesave të dëmtuara, duke kontribuar me financime pjesore. Përfitojnë në mënyrë të privilegjuar nga ky program ato asamble bashkëpronarësh që, të paktën, plotësojnë njërin nga këto kritere: b) kërkojnë përshtatjen e hyrjeve dhe të shkallëve për personat me aftësi të kufizuara”.

Mbështetur në legjislacionin e sipërpërmendur, Bashkia Sarandë ka vepruar duke lëshuar Autorizimin nr. 2044/1, datë 31.07.2018, nëpërmjet së cilit është mundësuar vendosja e një rampe me konstruksion të lehtësuar metalik për përshtatjen e ndërtesës dhe garantimin e aksesit të ankuesit dhe Z. F.Z., si persona me aftësi të kufizuara në pallatin, ku banojnë. Kjo mundësoi kalimin e personave me aftësi të kufizuar në të gjithë verandën e pallatit. Përveç sa më sipër, Bashkia Sarandë ka caktuar edhe një vendparkimi posaçërisht për Z. T.M., në kushtet kur ai gëzon statusin e personit me aftësi të kufizuara.

Për sa më sipër, Komisioneri çmon se në zbatim të legjislacionit të mësipërm, Bashkia Sarandë ka marrë fillimisht masat e nevojshme për të siguruar aksesueshmërinë e Z. T.M., si person me aftësi të kufizuar, në banesën e tij. Por pavarësisht kësaj, Komisioneri ka konstatuar gjithashtu, se pavarësisht lehtësive dhe kushteve që Bashkia Sarandë ka krijuar për Z. T.M., ankuesi nuk arriti dot t’i gëzojë dhe t’i përdorë këto lehtësi, pasi veranda e pallatit ku ai banon, që është në bashkëpronësi ndërmjet banorëve të pallatit dhe Z. Vladimir Hysi, përdoret nga ky i fundit për të ushtruar biznesin e tij privat.

Bashkia Sarandë nuk ka garantuar të drejtën e ankuesit për të patur akses për banesën e tij, nëpërmjet verandës së pallatit, duke përdorur rampën. Në këtë mënyrë, ky institucion, pavarësisht ankesave të depozituara nga Z. T.M. nuk ka ndërhyrë në bazë të kompetencave që i atribuon Vendimi nr. 447, datë 16.06.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, duke mos garantuar

¹⁵Neni 5, pika 1, e ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”parashikon: “*Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.*”

të drejtën e tij për një strehim të përshtatshëm. Zgjidhja e ofruar për ankuesin ka qenë ajo gjyqësore, ndërkohë që ka qenë detyrimi parësor i Bashkisë Sarandë për të ndërhyrë e për të zgjidhur situatën konkrete.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se ankuesi T.M. është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Bashkisë Sarandë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (së ndryshuar), nenet 209 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ligjin nr 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, gërmën “a”, të pikës 2, të nenit 5 dhe nenin 6 të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, pikën 3, të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, gërma a), e nenit 9, gërmat a) dhe b) të nenit 10, nenin 40, pika 1, gërma b) të ligjit nr. 10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, nenet 35-36 të Vendimit nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të Z. T.M., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Bashkia Sarandë.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit të Z. T.M., për shkak të gjendjes shëndetësore, nga Bashkia Sarandë.
3. Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Sarandë për të garantuar të drejtën e ankuesit, për të patur akses të lirë në verandën e pallatit ku jeton dhe për ta përdorur si rrugë të lirë kalimi për në banesën e tij.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë Vendim, Bashkia Sarandë të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

6. Gjoba të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.
7. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – te mira dhe sherbime
Shkak - aftesi e kufizuar